

rainbow[®]
MINIJET[®]




Numri I Kujdesit Të Klientëve

Si pjesë përbërëse e programit të kujdesit të klientëve të Rexair-it, çdo MiniJet-i Rainbow i jepet një numër seriali i kujdesit të klientëve vetëm pasi të ketë kaluar testimin e sigurimit të kontrollit të cilësisë. Ky numër seriali ofron:

- ✓ Identifikimi i pronësisë për ju
- ✓ Identifikimi i garancisë për shpërndarësin tuaj
- ✓ Siguri për kalimin e testimit të kontrollit të cilësisë
- ✓ Siguri për gjendjen e "sapo dalë" nga fabrika

Për referim në të ardhmen, shënojeni numrin e serialit në vendin bosh më poshtë. Asnjë MiniJet Rainbow i ri nuk duhet shitur pa këtë numër. Në qoftë se mungon numri i serialit, Rexair-i nuk e garanton origjinën, moshën ose gjendjen e pajisjes. Në qoftë se nuk arrini të gjeni numrin e serialit në MiniJet-in Rainbow, lutemi kontaktoni departamentin e shërbimit të klientëve të Rexair-it.

NUMRI SERIAL I MINIJET-IT



SHPËRNDARËSI JUAJ I AUTORIZUAR I RAINBOW-T

EMRI	
ADRESA	
QYTETI/SHTETIT/ KODI POSTAR	
TELEFONI	
EMAILI	

← Kontaktoni shpërndarësin tuaj lokal të autorizuar të Rainbow-t për këshilla në lidhje me kujdesin për MiniJet-in tuaj, mbulimin nga garancia, pjesët e ndërrimit dhe informacion për servisin.

Rexair[®]
LLC

50 W. Big Beaver Road, Suite 350 | Troy, Michigan 48084 | USA
(248) 643-7222 | custserv@rexairllc.com | rainbowsystem.com

© 2019 Rexair LLC, all rights reserved. Rainbow®, RainbowMate®, MiniJet®, JetPad®, RainMate®, RainJet®, AquaMate®, Rexair®, The Power of Water®, Wet Dust Can't Fly® and the configuration of the Rainbow® Cleaning System are registered trademarks of Rexair LLC, Troy, Michigan, United States.

Udhëzime Të Rëndësishme Sigurie



KY SIMBOL NËNKUPTON “KUJDES!” Gjatë përdorimit të një pajisje elektrike duhet të ndiqen gjithmonë masat parandaluese, përfshirë sa vijon:



KY SIMBOL NËNKUPTON “JU LUTEM LEXONI TË GJITHA UDHËZIMET PËRPARA PËRDORIMIT TË KËSAJ NJËSIE.”



KY SIMBOL NËNKUPTON “KJO ËSHTË NJË PAJISJE PASTRIMI ME THITHJE ME UJË PËR THITHJEN E SËLUCIONEVE ME BAZË UJIN QË MUND TË NDODHEN NË PËRMBAJTJE TË DETERGJENTËVE NË FORMË SHKUME.”

IPX4 IPX4 ËSHTË NIVELI I MBORJTJES NDAJ HYRJES SË UJIT.

⚠ PARALAJMËRIM: PËR TË ULUR RREZIKUN E ZJARRIT, ELEKTROSHOKUT OSE LËNDIMIT

1. Mos u largoni nga pajisja kur është në prizë. Hiqeni nga priza kur nuk është në përdorim dhe përpara se t'i bëni servis.
2. Për të ulur rrezikun e elektroskokut, përdoreni vetëm brenda.
3. Për të shmangur rrezikun e elektroskokut dhe për të ulur rrezikun e zjarrit, përdorni vetëm produkte pastrimi Rainbow të caktuara për përdorim me këtë makineri.
4. MiniJet-i ka pompë elektrike. Për të shmangur rrezikun e elektroskokut, MOS e fusni trupin e MiniJet-it në ujë kur mbushni ose pastroni rezervuarin.

⚠ E RËNDËSISHME

5. Rezervuari i MiniJet-it është krijuar për të përdorur vetëm solucionin shampo të Rainbow-t “AquaMate Shampoo” dhe ujë çezme të pastër dhe të ftohtë. Për të shmangur dëmtimin e MiniJet-it, mos vendosni brenda në rezervuarin e ujit asnjë nga të mëposhtmet:
 - Lëngje ose ujë të nxehtë
 - Përbërje ose lëngje pastrimi të disponueshme në treg
6. Mos e përdorni në bordura druri të papërfunduara, të vajosura ose të dyllosura, pllaka të pangjitura sepse ato mund të jenë të ndjeshme ndaj ujit.

7. Mos e përdorni MiniJet-in kur rezervuari i ujit është bosh. Kjo mund të çojë në dëmtimin e pompës.
8. Mos e zhysni trupin e MiniJet-it në lëngje.
9. Për udhëzime të mëtejshme në lidhje me sigurinë, referojuni Manualit të Pronarit të Rainbow-t.

Servisi I Pajisjes Me Izolim Të Dyfishtë


Në një pajisje me izolim të dyfishtë, janë vendosur dy sisteme izolimi në vend të tokëzimit. Një pajisje me izolim të dyfishtë nuk përmban asnjë mjet tokëzimi dhe pajisjes nuk duhet t'i shtohet mjet tokëzimi. Servisi i një pajisjeje me izolim të dyfishtë kërkon kujdes të jashtëzakonshëm dhe njohuri të sistemit dhe duhet bërë vetëm nga personel servisi i kualifikuar i Rainbow-t. Pjesët e ndërrimit për një pajisje me izolim të dyfishtë duhet të jenë identike me pjesët që do të zëvendësojnë. Në një pajisje me izolim të dyfishtë, shënohen fjalët “IZOLIM I DYFISHTË” ose “IZOLUAR NË MËNYRË TË DYFISHTË”. Gjithashtu mbi pajisje mund të shënohet edhe simboli (katror brenda katrorit). Çfarëdolloj servisi përveç pastrimit duhet kryer nga një shpërndarës ose qendër servisi e autorizuar i Rainbow-t.



RUAJINI KËTO UDHËZIME

KJO PAJISJE KA PËR QËLLIM VETËM PËRDORIMIN SHËTËPIAK. PËRDORENI MINIJET-IN VETËM SIPAS UDHËZIMEVE NË KËTË MANUAL TË PRONARIT. PËRDORENI MINIJET-IN VETËM ME MODELIN RHCS19 TË RAINBOW-T.

Njihuni Me MiniJet®-In Tuaj



1. Vegla thithëse e MiniJet-it
2. Lentja e veglës thithëse të MiniJet-it
3. Trupi i MiniJet-it
4. Rezervuari i MiniJet-it
5. Zorra e MiniJet-it
6. Mbërthesa e zorrës së MiniJet-it
7. Susta e MiniJet-it
8. Rainbow*
9. Legeni i ujit dhe karroca e Rainbow-t*
10. Koncentrati shampo "AquaMate Shampoo Concentrate" i Rainbow-t

*Nuk përfshihet

Vënia Në Vend Dhe Mirëmbajtja

- Hiqeni veglën thithëse nga gypi i zorrës. Hiqeni lentin dhe shpëlajeni me ujë derisa të pastrohet.
- Përpara se ta vini në vend MiniJet-in, zbrazeni rezervuarin dhe derdheni ujin e tepërt që ka mbetur në enën e rezervuarit duke e thithur me tubin e zorrës së MiniJet-it.
- Vëreni në vend dhe lëreni të thatet.

Udhëzues Për Fillim Të Shpejtë

1. Përgatitsni Dyshemenë...

- Përdorni Rainbow-n për të fshirë të gjithë zonën që duhet pastruar duke u siguruar që të mos mbetet asnjë mbeturinë mbi sipërfaqe.
- Zbrazni dhe shpëlani legenin me ujë. Mos e rimbushni.

2. Përgatitsni MiniJet-In...

- Filloni me legenin e ujit bosh. Bashkoni Rainbow-n dhe karrocën.
- Bashkoni MiniJet-in duke e shtyrë mbërthesën e zorrës në vrimën për hyrjen e ajrit të Rainbow-t derisa të mbërthehet.
- Mbushni një kapak plot me solucionin e koncentratit të shamos së Rainbow-t “AquaMate Shampoo Concentrate” dhe hidheni te rezervuari i MiniJet-it.
- Mbusheni pjesën e mbetur të rezervuarit të MiniJet-it me ujë çezme të ftohtë dhe të pastër dhe mbylleni kapakun të shtrënguar mirë.
- Futeni rezervuarin e MiniJet-it në trupin e MiniJet-it derisa ta dëgjoni që është mbërthyer plotësisht.

3. Pastrimi...

- Ndizeni Rainbow-n në funksionin më të lartë.
- Shtypni sustën e MiniJet-it dhe lëshojeni solucionin mbi tapet ose tapiceri. Lëshojeni sustën dhe përdorni vegël thithëse për të pastruar sipërfaqen nëpërmjet lëvizjeve përpara dhe prapa.
- Thithni lëngun e mbetur duke përdorur lëvizje shumë të ngadalta prapa.
- Për një tapet ose tapiceri shumë të thatë thitheni të gjithë pjesën për herë të dytë.
- Kur të mbaroni pastrimin, zbrazeni dhe shpëlajeni legenin e ujit të Rainbow-t. Lëreni të thahet.
- Shpëlajeni rezervuarin e MiniJet-it me ujë çezme të ftohtë dhe të pastër. Lëreni të thahet.

Pyetje Të Bëra Shpesh

A është MiniJet-i i sigurt për t'u përdorur në tapetin dhe tapicerinë time?

Në qoftë se keni ndonjë dyshim për sigurinë e solucionit të koncentratit të shamos së Rainbow-t “AquaMate Shampoo Concentrate” në tapetin, tapicerinë ose stofin tuaj, vendosni një sasi të vogël solucioni mbi një pjesë të vogël në një vend të padukshëm të sipërfaqes që do pastroni. Është gjë e mirë që të bëni një pastrim provë fillestar në një vend të fshehur të tapicerisë për t'u siguruar që nuk do ta dëmtojë tapetin ose tapicerinë.


A është i sigurt MiniJet-i për përdorim pranë kafshëve shtëpiake?

Po, kur përdoret një kapak plot sipas rekomandimit, shampoja e Rainbow-t “AquaMate Shampoo” nuk i dëmton kafshët shtëpiake.

Ku mund ta dërgoj MiniJet-in për servis ose të blej solucion shtesë të koncentratit të shamos “AquaMate Shampoo Concentrate” të Rainbow-t?

Kjo pajisje e Rainbow-t është testuar dhe inspektuar plotësisht. Për çështje servisi ose për të blerë pjesë zëvendësuese ose solucion shtesë “AquaMate Shampoo Concentrate”, ju lutemi kontaktoni shpërndarësin tuaj lokal të autorizuar të Rainbow-t. Në qoftë se nuk arrini ta kontaktoni shpërndarësin prej të cilit bletë pajisjen, vizitoni rainbowsystem.com për të gjetur një shpërndarës të autorizuar të Rainbow-t pranë jush.

1




2




3



4




5




6




7



8



9




10




11



12




13



14



15





rainbowsystem.com

Rexair LLC | Troy, Michigan

© 2019 Rexair LLC | R17492AA-0